



Kontrollimet e rregullta të rezultateve të punës së nxënësve, gjykimet dhe vlerësimet e punës dhe të sjelljes janë pjesë përbërëse me rëndësi të procesit të shkollimit dhe duhen, nga secili mësimmshënës, gjatë tërë shkollimit të planifikohen me kujdes.

Në mënyrë që të kemi një vlerësim të drejtë dhe të barabartë, duhet përdorur burime të shumta informatash, para së gjithash shfrytëzimi i formave të ndryshme të vrojtimit. Një sistem i mirë i vlerësimit në vete përmban Vrojtimin - Gjykimin - Vlerësimin.

Secili, që fillon me shkollim profesional duhet të ketë kohë të mjaftueshme për adaptim dhe tek pas kësaj mësimmshënësi duhet të filloj me vrojtimet e tij.

Pyetjet për mësimmshënës

- Përse vlerësoj unë?
- Si vlerësoj unë?
- Kur vlerësoj unë?
- Çka vlerësoj unë?

Gjatë shkollimit janë treguar të suksesshme pyetjet kontrolluese gojore lidhur me ecuritë e punëve, të cilat, para së gjithash, janë pjesë përbërëse të mësimit praktik. Mësimmshënësi, përmes vrojtimit, mund të përcaktojë se a është nxënësi duke e kryer punën siç duhet dhe ti jap atij ndonjë shenjë.

Pas çdo njësie mësimore të rëndësishme duhet zhvilluar detyra ushtrimi apo teste me shkrim. Detyrat e lira, ku nxënësi mund të shprehë temën me fjalë të veta, kanë prioritet parësor. Krahas kësaj duhet përdorur teste të programuara tek të cilat mundësitë e përgjigjeve janë pak a shumë të dhëna.

Me rëndësi të madhe janë kriteret konkrete të vlerësimit të punës dhe sjelljes së secilit nxënës.

Këto kriteret, nxënësi dhe mësimmshënësi duhet ti përcaktojnë në mes vete që në fillim të shkollimit.

Për të fituar një pasqyrë sa më reale të zhvillimit të përgjithshëm të nxënësit, nevojiten vlerësime të rregullta.

Është treguar e suksesshme puna me formularët e vrojtimit, në të cilat mund të përmbliken vlerësime të rastësishme, neutrale dhe në periudha të ndryshme kohore.

Në bazë të këtyre vrojttimeve, mësimsdhënësi mund të nxjerrë përfundime lidhur me anët e forta dhe të dobëta, përfundime të cilat nuk duhet „betonuar“.

Shembull i një formulari vrojtues

Data	Vrojtimet
5.1.	Vije 15 min. me vonesë
8.1.	Pastron me shumë kujdes vendin e punës
12.1.	Në biseda mësimore mjaft i rezervuar
15.1.	Shprehet negativisht mbi anëtarët e grupit: „Që të gjithë ata nuk kanë lidhje!“
17.1.	...

Vrojtimet vlerë - neutrale, gjithmonë duhet të jenë të lidhura me vrojtimet sistematike dhe qëllimore. Vetëm kështu është i mundur një krahasim në mes të nxënësve.

Secili mësimsdhënës duhet pasur kujdes që të mos formuloj numër të madh të kriterëve vlerësues. Në shkollimin profesional janë treguar të suksesshme 6 deri maksimalisht 12 kriterie për secilën lëmi.

Një formular vrojtues i mirë, përmban kriterie nga këto katër lëmi në vijim:

Kriteret për vlerësim

Sjellja e përgjithshme e punës/ Mënyra e punës

Kujdesi, preciziteti, durimi, ndjenja për rregull, koncentrimi, aftësi duruese, përshtatja ndaj situatës së re, ...

Aftësitë teorike

Aftësia e të kuptuarit, kuptimi i porosive, të menduarit logjik, aftësia për paraftyrimin hapsinor, aftësitë matematikore, kreativiteti, aftësia e të shprehurit, ...

Aftësitë praktike

Siguria gjatë manipulimit të makinave dhe pajisjeve, koordinimi i veprimeve të veçanta, zotërimi i zhvillimeve lëvizëse respektivisht shkathtësive komplekse, natyrës së shkathësive, ...

Sjellja sociale

Gatishmëria për kooperim, ndjenja e përgjegjësive, gatishmëria për ndihmë, aftësia kontaktuese, format e shoqërimit, prezentimi, ...

Zgjedhja e kritereve është gjithmonë në varshmëri nga kërkesat profesionale. Në praktikën shkollore këtyre kritereve vlerësuese iu shtohen 5 nivele vlerash.

Niveli vlerësues i notimit

Kriteri	5	4	3	2	1
Durimi	Shkëlqyes-hëm	shumë mirë	mirë	mjaftues-hëm	dobët
Qëndrimi	Shkëlqyes-hëm	shumë mirë	mirë	mjaftues-hëm	dobët

Një qasje e tillë sistematike bazuar në këtë fomular vlerësimi mundëson edhe udhëheqjen e një bisede vlerësimi të përgatitur mirë.

Nëse ju si mësimmhënës përgatisni një bisedë vlerësimi, preferohet ti keni parasysh këta hapa:

1. Krijoni patjetër një atmosferë relaksimi, pa pengesa
2. Renditni aspektet pozitive në fillim të bisedës
3. Kritikën e domosdoshme në punën dhe sjelljen e nxënësit duhet të jenë objektive
4. Ju duhet gjithmonë të ofroni ndihmën tuaj, në mënyrë që të eliminoni mangësitë e definuara
5. Duhet ofruar propozime për përmirësim
6. Inkorporimi i vlerësimeve të mëparshme mund të jetë me përparësi për udhëheqjen e bisedës
7. I jepni gjithnjë mundësi nxënësit për vetëvlerësim, mëdyshjet e tij duhet ti merrni seriozisht dhe të mbani shënime me shkrim
8. Nëse nuk zgjidhen problemet e pranishme, duhet caktuar termi për bisedën tjetër



Sa më thelbësor dhe i hollësishëm të jetë planifikimi i punës suaj mësimore/ instruktimit, sa më qartë që të jenë të formuluarat qëllimet tuaja, aq më pak probleme do të keni me vlerësimin.

Sigurisht se me një plan të shkruar mirë, do të keni bazë më të mirë për notim objektiv të nxënësve.

Prapeseprapë paraqiten gabime gjatë vlerësimit. Duhet tu ikim burimeve të poshtëshënuara të gabimeve.

Burimet e gabimeve

- Simpatia dhe antipatia nuk guxojnë të kenë kurrëfarë ndikimi në vlerësim.
- Nëse ju si mësimdhënës keni dëgjuar për një shtëpi negative të prindërve, nuk guxoni automatikisht këtë mendim ta bartni edhe tek nxënësi. Mund të jetë plotësisht i gabuar.
- Ju si mësimdhënës duhet të jeni gjithmonë i gatshëm që të korigjoni përshtypjen e parë negative. Një gjykim i marrë njëherë nuk guxon të ndikojë në çdo gjë tjetër.
- Ju si mësimdhënës keni gjithnjë të bëni me ndryshime të mëdha në punën e grupeve të ndryshme. Analizoni vetëvehten se mos po oriento heni tepër në vlerësimin mesatar të grupeve dhe kështu disa nxënës i vlerësoni më tepër e disa më pak se që duhet.
- Nuk është e pranueshme që në bazë të një vetie të vrojtuar, automati kisht të vendoset edhe për tjetrën. Një konkluzion i tillë mund të jetë i gabuar.



*Çka mendoni lidhur me mendimin, në vijim, të mësimdhënësit Isuf?
„Nëse nuk them asgjë, a është kjo veç një lavdatë!“
„Kur jam i pakënaqur, do të lajmërohem!“*

Në këtë rast duhet të mendohemi mirë, se si do të mund ti motivonim nxënësit mirë dhe pozitivisht. Mirëpo, shumë më tepër kemi motivim negativ sesa pozitiv.

Vrojtoni ju veten tuaj njëherë në mënyrë kritike (ndoshta edhe si nënë apo baba në edukimin e fëmijëve). Sa shpejt i thotë njeriu fëmiut të tij:

„Nëse nuk e hanë spinaqin, nuk mund të shkosh të luash!“

Qëndrimi i fëmiut, zakonisht është i paraprogramuar. Më mirë do të ishte të thuhet:

„Nëse tani e han spinaqin, më pas do të mund të shkosh të luash!“